

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR VJOSA VALLEYSHPK

Në Tiranë, sot më datën 21.06.2023, u zhvillua mbledhja e anëtarëve themelues të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “**VJOSA VALLEY**” SHPK të cilët janë :

1. Shoqëria **Best Invest Shpk**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar me kapital 100% shqipëtar e rregjistruar në QKB e pajisur me numër nipt :L62318005A dhe me status aktiv, me adresë Njesia Administrative nr 2,Rruga Abdi Toptani ,Godina nr.1/202,Tiranë me përfaqesues ligjor z.Eglent Bici me numër identifikimi personal nr.H60828061U.
2. **Vilson Xhaferaj**, i biri i Nezir dhe i Festime, lindur më 15.03.1989, në Çorovodë dhe banues në Lagjia Nr.8, Rr. “Budapest”, ndërtesa Nr.15, Durrës, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit Nr.036152979 dhe numër personal I90315104B.
3. **Eglent Bicë** i Kasëm dhe i Lefteri, lindur më 28.08.1976, në Bicaj dhe banues në Lagjia Rruga“Myftar Gërbolli, vila Nr. 69, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit Nr.034665689 dhe numër personal H60828061U.

Të cilët duke u mbështetur në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe me vullnetin e tyre të lirë, vendosin të krijojnë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga ky Akt Themeli, Statuti i Shoqërisë si dhe nga ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

KAPITULLI I EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, OBJEKTI, SELIA DHE KOHËZGJATJA

Neni 1

Emërtimi dhe forma ligjore

- 1.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi tëkufizuar do të emërohet **VJOSA VALLEY SHPK**.
- 1.2 Shoqëria tregtare **VJOSA VALLEY SHPK** është person juridik me përgjegjësi të kufizuar dhe fiton personalitetin juridik dhe zotësinë e saj për të vepruar në momentin e regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 2

Statusi Ligjor



2.1 "VJOSA VALLEY" SHPK ka statusin juridik të rregulluar nga legjislacioni në fuqi, parashikimet e ligjit që rregullonë në mënyrë të veçantë veprimtarinë e shoqërive tregtare, ligji 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, si dhe nga akt themelimi dhe statuti i saj.

Neni 3 Ortakët

3.1 Ortakët e shoqëria tregtare VJOSA VALLEY SHPK do të jenë:

- Shoqëria **Best Invest Shpk** shoqëri tregtare me përgjegësi të kufizuar me kapital 100% shqipëtar e rregjistruar në QKB e pajisur me numër nipt :L62318005A, me adresë Njesia Administrative nr 2,Ruga Abdi Toptani ,Godina nr.1/202,Tiranë me përfaqesues ligjor z.Eglent Bici me numër identifikimi personal nr.H60828061U.
- **Vilson Xhaferaj**, i biri i Nezir dhe i Festime, lindur më 15.03.1989, në Çorovodë dhe banues në Lagjia Nr.8, Rr. "Budapest", ndërtesa Nr.15, Durrës, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit Nr.036152979 dhe numër personal I90315104B.
- **Eglent Bicë** biri i Kasëm dhe i Lefteri, lindur më 28.08.1976, në Bicaj dhe banues në Lagjia Rruga "Myftar Gërbolli, vila Nr. 69, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit Nr.034665689 dhe numër personal H60828061U.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

4.1 Objekti i veprimtarisë tregtare tëshoqërisë tregtare VJOSA VALLEY SHPK do të jetë ushtrimi i veprimtarisë tregtare në fushën e Bujqësisë dhe Agroturizmit si dhe çdo veprimtari tjetër tregtare e ushtruar brënda parashikimit ligjor të Kodit Civil si dhe ligjt 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Në fokus të veprimtarisë së shoqërisë do të jetë ndërtimi dhe kultivimi i plantacioneve me bimë arrore dhe frutave të tjera të thata, vreshtave, kultivimi i bimëve bujqësore, mbledhja, grumbullimi, magazinimi, përpunimi dhe tregëtimi i produkteve bujqësore, import eksport. Rritja dhe mbarshtimi i gjedhëve dhe blegtorisë, grumbullim dhe përpunim i produkteve dhe nënprodukteve blektorale, tregëtim i mishit, qumshtit dhe nënprodukteve të tyre,import eksport i tyre etj. Ushtrimi i veprimtarisë së agroturizmit, kulinarisë dhe hotelerisë dhe veprimtarive tregtare të lidhura me to, etj.

Neni 5 Selia dhe kohëzgjatja e veprimtarisë



- 5.1** Selia eshoqërisë tregtare VJOSA VALLEY SHPK do të jetë në Fashatin Qilarisht, Bashkia Përmet.
- 5.2** Kohëzgjatja e veprimatarisë do të jetë për një kohë të pacaktuar. Shoqëria mund të pezulloj veprimitarinë e saj me afat të caktuar ose të pacaktuar.
- 5.3** Veprimitaria e shoqërisë mund të ndërpritet në rastet e prishjes me vullnetin e ortakëve, në rastet e falimentimit, likujdimit të saj, si dhe në rastet e parshikuara nga legjislacini në fuqi.

Neni 6 Organet Drejtuese

- 6.1** Organet drejtuese të Shoqërisë do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori i Shoqërisë.

Neni 7 Vula dhe Logo

- 7.1** Shoqëria tregtare VJOSA VALLEY SHPK ka vulën dhe Logon e saj forma e të cilave vendoset me miratimin e organit me të lartë vendimarrës.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT, BURIMET FINANCIARE

Neni 8

Kapitali Themeltar

- 8.1** Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë lekë) i ndarë në **3** kuota. Çdo kuotë jep të drejtën e votës, pesha e të cilës është në raport me pjesën zotëruese të kapitalit. Kapitali themeltar nënshkruhet tërësisht nga ortakët.
- 8.2** Pjesët e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga ortakët si në vijim:

- Ortaku **Vilson Xhaserraj** zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 45% (dyzetë e pesë përqind) të kapitalit, me vlerë 45 000 (dyzetë e pesë mijë) lekë të kapitalit themeltar.
- Ortaku Shoqëria **Best Invest Shpk** zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit, me vlerë 30 000 (tridhjetë mijë) lekë të kapitalit themeltar.
- Ortaku **Eglent Bicizot** zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit, me vlerë 25 000 (njëzetë e pesë mijë) lekë të kapitalit themeltar.

Neni 9 Ndryshimi i Kapitalit Themeltar




- 9.1 Ndryshimi i kapitalit themeltar mund të bëhet nëpërmjet zmadhimin të kapitalit ose zvogëlimin e tij. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet pa kufij ndërsa zvogëlimi i tij deri në kufijtë e pranuar nga ligji.
- 9.2 Ndryshimi i kapitalit në çdo rast mund të bëhet me miratimin e ortakëve që zoterojnë minimalisht 3/4 e kuotave të kapitalit të shoqërisë me vendimin përkatës.

Neni 10

Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave

- 10.1 Të drejtat mbi kuotën dhe kapitalin themeltar mund të transferohen vetëm nëpërmjetveprimit juridik të kryer me akt notarial, nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, dhurimit, trashëgimisë si dhe mënyretjetër të parashikuara në ligj.
- 10.2 Të drejtat mbi kuotën dhe kapitalin themeltar janë lehtësish të transferueshme mes ortakëve të cilët gjëzojnë të drejtën e prarablerjes si dhe janë të transferueshme nëpërmjet shitblerjes edhe kundrejt të tretëve. E drejta e parablerjes rezervohet për një afat deri në 1 (një vit) nga koha e kërkesës për shitjen e kuotës nga ortakët e shoqërisë.
- 10.3 Të drejtat mbi kuotën dhe kapitalin themeltar janë të transferueshme nëpërmjet shitblerjes kundrejt të tretëve, vetëm mbasi të jetë ezauruar ushtrimi i të drejtës së parablerjes nga ortakët e shoqërisë dhe këta të fundit të kenë hequr dorë nga kjo e drejtënpërmjet një veprimi juridik të kryer me akt notarial.
- 10.4 Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre dhe dispozitat e këtij neni që zbatohen për kalimin e kuotave zbatohen edhe për pjestimin e kuotave.
- 10.5 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Burimet financiare

- 11.1 Burimet financiare të shoqërisë janë të ardhura e nga aktiviteti tregtar i shoqërisë, të ardhura nga huaja e marrë pranë institucioneve financiare, huat e ortakëve në favor të shoqërisë, grantet dhe çdo burim tjetër i ligjshëm referuar legjislacionit në fuqi.
- 11.2 Për marrjen e huave dhe shumën e huasënë institucionet financiare vendoset me shumicë të zakonshme të ortakëve të shoqërisë.
- 11.3 Huaja e ortakëve në favor të shoqërisë jepet pa interesa dhe përcaktohet me vendim të zakonshëm të ortakëve në propocion me kuotën e secilit ortak në shoqëri.
- 11.3 Shoqëria tregëtare harton një strategji të përvitshme dhe ka objektiv të rëndësishëm aplikimin me projekte zhvillimore për grante të ofruara nga institucione të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, vëndase dhe të huaja.



KAPITULLI III **MARDHËNIET EKONOMIKE MES SHOQËRISË DHE ORTAKËVE**

Neni 12

Viti Financiar

- 12.1** Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar me 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.
- 12.2** Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likujduese pranë bankave dhe të kryejë veprime likujduese me to, brenda dhe jashtë vendit.
- 12.3** Llogaritë vjetore, invenarët, raportet mbi operacionet e vtitit financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brënda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vtitit financiar.
- 12.4** Bilanci vjetor ishoqërisë duhet të hartohet për tiu paraqitur organeve tativore deri në fund të muajit Mars të vtitit pasardhës.
- 12.5** Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë të cilat do të konvertohen çdo muaj në monedhën shqiptare.
- 12.6** Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale ndaj shtetit, fitmi neto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit, për rritjen e kapitalit të shoqërisë ose i shpërndahet ortakëve sipas kuotave të zotëruara.

Neni 13

Shpërndarja e fitimeve

- 13.1** Me propozim të Administratorit, me përjashtim të rasteve kur vendosin ndryshe, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë dhe fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
- 13.2** Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendifit:
 - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 13.3** Administratori lëshonë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përbush kërkeshat e pikës 1 të këtij nenit, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përbush këto kriteret, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
- 13.4** Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Neni 14

A handwritten signature in black ink, appearing to be a personal or professional signature.

Përgjegjësia pér shpérndarjet e palejuara

- 14.1** Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, sipas pikës 13.3 të statutit, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë pér kthimin e dividendëve të shpérndarë.
- 14.2** Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë pér kthimin e dividendëve, që u janë shpérndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni pér gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, sipas pikës 13.2 të statutit, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni pér këtë gjendje.


KAPITULLI IV ORGANET E SHOQËRISË

Neni 15 Organet Drejtuese

- 15.1** Organet drejtuese të shoqërisë janë:
 - Asambleja e Përgjithshme.
 - Administratori i shoqërisë.
- 15.2** Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës dhe në përberje të tij janë ortakët të cilët zotërojnë kuota të kapitalit të shoqërisë. Asambleja zgjedh Kryetarin e saj me shumicë absolute të votave të saj, kur marrin pjesë në mbledhje të paktën ortakët të cilët zotërojnë 3/5 e kuotave.
- 15.3** Administratori i Shoqërisështë i zgjedhuri me shumicë absolute të asamblesë të përgjithsme të shoqërisë pér drejtimin ekzekutiv të saj.

Neni 16 Asambleja e Përgjithshme

- 16.1** Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse pér marrjen e vendimeve pér shoqërinë pér çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpérblimeve pér personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

16.2 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 16.1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

16.3 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

16.4 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 17



Mënyra e thirrjes të Asamblesë

17.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi nëpërmjet postës elektronike ose në pamundësi objektive nëpërmjet njoftimit me shkresë. Njoftimi me mesazh elektronik apo me shkresë, duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

17.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

17.3 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 17.1 të nenit 17 të statutit.

17.4 Nëse, në kundërshtim me pikën 17.3 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:



- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratori/rët nuk përbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

17.5 Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 17.3 dhe 17.4 të këtij nenit dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 17.1 të nenit 17 të këtij statuti.

Neni 18

Përfaqësimi në Asamble

18.1 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet edhe vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

18.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

18.3 Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

Neni 19

Marrja e vendimeve dhe korumi

19.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme (shumicën absolute të ortakëve të pranishm në mbledhje), asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas pikës 16.2 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 20 të këtij statuti.

19.2 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

19.3 Për çështjet e tjera të renditura në nenin 15 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

19.4 Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 20

Edrejta e votës



[Handwritten signature]

- 20.1** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 20.2** Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
- 20.3** Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
 - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
- 20.4** Përdorimi i mjetave elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
- 20.5** Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.


Neni 21

Vendimet e Asamblesë

- 21.1** Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
- 21.2** Prosesverbal duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 21.3** Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 21.4** Prosesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 21.5** Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorëi, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 22

Të drejtat lidhur me kuotën



- 22.1** Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkuhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.
- 22.2** Janë të pavlefshme veprimet e Administratorit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarin dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.
- 22.3** Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarin dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar.

Neni 23 Administratori

- 23.1** Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë me shumicë absolute të votave kur marrin pjesë ortakët që zoterojnë të paktën 3/5 e kuotave. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 23.2** Administrator i shoqërisë emërohet z. **Vilson Xhaferaj**, lindur më 15.03.1989, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit Nr. 036152979 dhe numër personal I90315104B, me një afat emërimi 5 (pesë) vjeçar.
- 23.3** Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare me të tretët ose të emroj përfaqësues në vend të tij për këtë qëllim;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejnë regjistimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

- 23.4** Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë për shkaqe tëpërligjura në mospërbmbushje të detyrave të përcaktuara në këtë statut, me shumicë zakonshme votash. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë




këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 24

Përfaqësimi Ligjor

- 24.1 Tagrat e përfaqësimit të administratorëve si dhe kufizimi i tyre, i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me këtë statut si dhe dispozitat e nenit 12 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarin dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar.

Neni 25

Shpërblimi

- 25.1 Për punën që kryen administratori merr një shpërblim bazë i cili përcaktohet me vendim të zakonshëm të asamblesë. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Edhe shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.
- 25.2 Shpërbli i parashikuar në pikën 25.1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
- 25.3 Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Neni 26

Detyrimet dhe përgjegjësia

- 26.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarin dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, administratorët detyrohen:
- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
 - b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarin dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar,
 - dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 26.2 Administratori/rët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 26.3 Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standartet profesionale, sipas pikave 26.1 e 26.2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblojnë shoqërisë dëmet, që



rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruar.

KAPITULLI V

LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE DHE PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 27


Largimi i ortakut

- 27.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
- 27.2 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.
- 27.3 Administratori/rët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 27.2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
- 27.4 Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
- 27.5 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.
- 27.6 Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpérblimin e dëmit të pësuar.

Neni 28

Perjashtimi i Ortakut

- 28.1 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
- 28.2 Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 28.1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:
- me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
 - me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
 - përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
 - me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.



- 28.3** Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.
- 28.4** Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
- 28.5** Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.
- 28.6** Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria nre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

Neni 29

Pasojat e largimit dhe përjashtimit

- 29.1** Ky status garanton e drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.
- 29.2** Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

Neni 30

Prishja e Shoqërisë

30.1 Shoqëria Prishet:

- a) me vendim të Asamblesë të Përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit
- c) me vendim gjykatës

30.2 Vendimi për prishjen e shoqërisë duhet të registrohet nga Administratoripranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit në përbushje të parashikimit të legjisacionit në fuqi.

Neni 31

Likuidimi i shoqërisë

31.1 Kur është vendosur prishja e shoqërisë sipas parashikimit të dispozitës të nenit 30 të statutit, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarin dhe shoqëritë tregëtar” i ndryshuar.

31.2 Për administrimin e kësaj procedure, Asambleja e Ortakëve emëron një ose disa likuidatorë, të cilët përgatisin raporte përfundimtare mbi bilancin financier të shoqërisë, mbi veprimet ligjore të mëtejshme të likuidimit dhe kohëzgjatjen që do të marrë ky process.

31.3 Pas përfundimit të procedurës së likuidimit, Asambleja vendos mbi bilancin financier përfundimtar dhe mbi përfundimin e procedurave të likujdimit.



31.4 Pas mbledhjes së kredive dhe shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuidatori do të shpërndajëpjesën e mbetur të likuidimit Ortakëve të shoqërisë, në propocion me kuotat e kapitalit të zotëruar prej tyre.

31.5 Likuidatori ka detyrimin që të njoftojë Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e procesit të likuidimit duke kërkuar çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”.

KAPITULLI VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 32

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

32.1 Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

32.1 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje të mosmarrveshjeve me mirëkuptim, palët do ti drejtohen për zgjidhjene tyre Gjykatës Civile të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 33

Dispozitat Ligjore

33.1 Ky Statut është hartuar në mbështetje të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe konkretisht në :

- Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar;
- Ligjin Nr 9723, datë 03.05.2007 “Për qëndrën kombëtare të biznesit”, i ndryshuar.

33.2 Për çështje të cilat nuk janë rregulluar drejt në këtë Statut, Shoqëria do të referohet për zgjidhjen e tyre në aplikimin e drejtpërdrejtë të dispozitave ligjore të parashikuara në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

33.3 Statuti, u hartua në përbërje të tij prej 33 Nene dhe redaktohet në4 (katër) kopje identike në gjuhën shqipe, nga të cilat një kopje për secilin themelues dhe mjë kopje në arkivat e shoqërisë të krijuar VJOSA VALLEY SH.P.K, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

ORTAKËT

Shoqëria “Best Invest” Shpk

Administrator

Eglent BICI



Vilson XHAFERRAJ